



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Bazuar në nenin 83 par.2 të Statutit të OAK, Këshilli Drejtues i Odes së Avokatëve të Kosovës në seancën e mbajtur më 28 dhjetor 2013 nxjerr:

**RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E  
KOMITETEVE**

**Kreu I.  
DISPOZITAT E PËRGJTHSHME**

**Neni 1**

1. Komitetet janë formë të aktivitetit dhe veprimit të Këshillit Drejtues të OAK, përmes të cilëve Këshilli Drejtues ushtron aktivitetin e përcaktuar me Statutin e Odes. Përmes aktivitetit të Komiteteve realizohet edhe misioni i Odes dhe synimet strategjike të saj. Vet aktiviteti i tyre duhet të zhvillohet në përputhje me misionin e OAK.
2. Komitetet themelohen nga Këshilli Drejtues, i cili edhe i emron anetarët e tyre. Ato formohen në fushat e caktuara për zbatimin praktik të aktivitetit të Këshillit. Me atë rast Këshilli duhet të ketë parasysh misionin e përgjithshëm të Odes, planet për zhvillimin strategjik dhe prioritetet ekzistuese.
3. Komitetet janë edhe zbulues të ideve, nevojave dhe synimeve të ardhme të OAK. Secili komitet duhet t'i zhvillojë kapacitete të këtualla. Komitetet aktivitetin e vet duhet ta mbështesin në strategjinë e Odes.

**Kreu II  
ORGANIZIMI DHE KOMPETENCAT**

**Neni 2**

1. Me vendimin për themelimin, Këshilli do të përshkruajë fushëveprimin dhe detyrat e komitetit si dhe do të caktojë numrin e antarëve dhe udhëheqësin e tij.
2. Komitetet do të promovojnë dhe zhvillojnë standardet nga sfera e fusheveprimit të vet, duke përpiluar dhe realizuar projekte dhe programe.
3. Për çështjet nga fusheveprimi i vet Komitetet mund të bëjnë rekomandime dhe sygjerime Këshillit Drejtues.

**Neni 3**

1. Në fushat e aktivitetit Këshilli Drejtues i Odes do të themelojë Komitete të përhershme.
2. OAK, do t'i ketë këto Komitete të përhershme:
  - 1) Komiteti për Praktikant

- 2) Komitetin për Planifikimin Strategjik,
- 3) Komitetin për Etike dhe Sistem Disiplinor,
- 4) Komitetin për Legjislacionit dhe çështje normative,
- 5) Komiteti për çështje gjinore
- 6) Komiteti për çështjen e komuniteteve joshumice.

3. Këshilli Drejtues i OAK mund të themeloj edhe komitete të tjera të përhershme, nga fusheveprimi i vet.

4. Komitetet e përhershme kanë obligim që Këshillit Drejtues ti paraqesin planin vjetor të punës dhe propozim buxhetin 30 dite para mbajtjes së Kuvendit vjetor të OAK.

#### **Neni 4**

Komitetet, me qëllim të veprimit me efikas, për fushat e caktuara të aktivitetit të vet mund të krijojnë grupe dhe seksione, punën dhe aktivitetin e të cilëve e drejtojnë dhe e mbikqyrin vet, në procedurat e percaktuara nga vet ata.

#### **Neni 5**

Komitetet e përhershme, së paku cdo 6 muaj do të raportojnë për punën dhe aktivitetin e vet Këshillit Drejtues.

#### **Neni 6**

1. Për çështjet e caktuara ditore-të ashtuquajtura *ad-hoc*, Këshilli Drejtues do të formojë Komitetet e përkohshme. Ato krijohen për një çështje a detyrë të caktuar.

2. Te këtilla mund të jenë: programet dhe shërbime të caktuara përfitimi për anetarët dhe komunitetin, pastaj programe komunikimi me gjykatat dhe organet e autoritetet e tjera, për fillimin, mbështetjen dhe realizimin e iniciativave dhe politikave ditore.

3. Komitetet e përkohshme pushojnë së funksionuari me perfundimin e projektit respektivisht zgjedhjen e çështjes për të cilën janë formuar.

#### **Neni 7**

1. Kryetari i Komitetit drejton aktivitetin, thërret dhe udheheq mbledhjet e Komitetit. Për kryetar të Komiteteve do të zgjedhet avokati që:

- shquhet me angazhimin dhe punën e vet,
- është entuziast,
- ka njohuri për qëllimet e organizates dhe funksionet e komitetit si dhe
- e ka besimin e anetarëve të tjerë.

2. Për anetarë të komiteteve mund të zgjedhen personat përvoja e të cileve, aftësit dhe interesat i mbështesin objektivat e komitetit.

3. Anetarët janë të detyruar që të marrin pjesë në aktivitetin e Komitetit, në të cilin janë zgjedhur, t'i ndjekin takimet në menyrë të rregullt, të kuptojnë punën dhe detyrat që u caktohen dhe të marrin përgjegjësinë për zbatimin e tyre.

4. Numri i anetarëve të Komiteteve përcaktohet varësisht nga sfera, dedikimi dhe detyrat e komitetit. Numri i anetarëve të Komiteteve të përhershme nuk mund të jetë më i vogël se 5.

#### **Neni 8**

1. Mandati i anetarëve të Komiteteve të përhershme dhe të përkoheshme është dy vite me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat.

2. Mandati i anëtarit të Komitetet mund të përfundojë edhe para kohe:
- me vendimin e Këshillit Drejtues,
  - me kërkesën e vet anëtarët/dorëheqje apo kërkesë për lirim nga detyra,
  - në rast të c' regjistrimit nga regjistri i OAK,
  - në rast se tri herë pa arsye nuk merr pjese në punën dhe aktivitetin e Komitetit.

#### **Neni 9**

1. Në aktivitetet e Komiteteve mund të angazhohen edhe profesionist të tjerë me njohuri të vecanta nga lëmia e fushëveprimit të komitetit.
2. Statusi i anëtarëve nga par.1 i këtij neni përcaktohet nga Këshilli Drejtues, me vendimin për caktimin e antarit.

#### **Neni 10**

Komitetet teknikisht ndihmohen nga administrata e Odes respektivisht në menyrën siq e përcakton Këshilli Drejtues.

#### **Neni 11**

1. Mbledhja e Komitetit mund të mbahet dhe nxjerr përfundime, nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e antarëve.
2. Komiteti nxjerr përfundime me shumicë votash të antarëve të pranishëm.

#### **Neni 12**

Anëtarët duhet të marrin pjesë në punën e Komitetit, ti ndjekin takimet në menyrë të rregullt, të kuptojnë punën dhe detyrat që u caktohen dhe të marrin përgjegjësinë për zbatimin e tyre.

#### **Neni 13**

1. Anëtarët e Komiteteve nuk mund ta shfrytëzojnë anëtaresin dhe angazhimin në Komitetet për t'i siguruar vetes apo kujdoqoftë privilegje dhe beneficione të çfarëdo natyre, për të ngritur rëndësinë në organizate apo për të shtuar famën.
2. Asnjë anëtar i Komitetit nuk mund ta shfrytëzojë anëtaresinë në Komitet për ta avancuar aktivitetin e vet politik apo interesat e cilesdo organizate tjetër të caktuar.

#### **Neni 14**

Anëtarët e Komiteteve janë të obliguar që në punën dhe aktivitetin e vet përherë të udhëheqen nga parimet e përcaktuara me Ligjin për Avokatinë, Statutin e OAK, Kodin e Etikës dhe këtë Rregullore.

### **Kreu III**

### **MBIKQYRJA, MONITORIMI DHE VLERËSIMI**

#### **Neni 15**

Kryetari i Komitetit duhet ta informojë Këshillin Drejtues për ecuritë e punës dhe aktivitetet e komitetit. Kryetari duhet ti informojë anëtarët e komitetit për përgjegjet dhe vendimet e Këshillit Drejtues.

#### **Neni 16**

Këshilli Drejtues i OAK do të sigurojë monitorimin e rregullt për të gjitha komitetet e formuara dhe të organizuara sipas kësaj rregulloreje. Monitorimi përfshinë mbikqyrjen e

punës, aktivitetin dhe shpenzimet e mjeteve te Komitetit. Per rezultatet e mbikqyrjes do te informohet edhe Kuvendi i OAK.

#### **Kreu IV**

### **SIGURIMI I KUSHTEVE PËR PUNËN E KOMITETEVE**

#### **Neni 17**

1. Këshilli Drejtues i Odës është i detyruar që të sigurojë kushte për punën dhe aktivitetin e Komiteteve.
2. Mjetet për financimin e aktivitetit të Komiteteve vijnë nga Buxheti i Odes, kurse vet komitetet nuk mund ti kene fondet e veta të vecanta.
3. Kryesuesi i Komitetit kujdeset qe shpenzimi e mjeteve të lejuara të bëhet sipas buxhetit të aprovuar nga Këshilli Drejtues.

#### **Kreu V**

### **DISPOZITAT PER FUNDIMTARE**

#### **Neni 18**

1. Riorganizimi i Komiteteve ekzistuese sipas kësaj rregullore do të bëhet me se voni në afat prej 3 muajsh prej hyrjes në fuqi te kësaj Rregullore.
2. Komitetet kanë obligim qe ti parashtrojnë Këshillit Drejtues planin e punës dhe Draft buxhetin 3 muaj pas hyrës ne fuqi te kësaj Rregullore.
3. Komitetet që nuk i përmbushin obligimet sipas par.2 te këtij neni do të shpërndahen nga ana e Këshillit Drejtues

#### **Neni 19**

Rregullorja hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe zbatohet nga 01 Janar 2014.

**Av.Ibrahim Z. Dobruna,**  
**Kryetar i OAK-së**